

atrc

Qendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA

Perkrah
komunitetin e OJQ-ve



AVOKUESI

Vëllimi IV • Numri 6 • Korrik 2006

PËRMBAJTJA

Faqe 2

Pensionistët kërkojnë ligj që garanton mirëqenie për pensionistët e tanishëm dhe të ardhshëm të Kosovës

"World Child Kosova" mbron dhe përkrah fëmijët dhe të rinjtë kosovar

Ngritja e kapacitetit të shoqërisë civile në shoqëritë post-konfliktuale:

Përvoja e Bosnjës e Hercegovinës dhe Kosovës

Faqe 3

Përfaqësues të shoqërisë civile bëjnë thirrje për reformim të sistemit zgjedhor në Kosovë

Pjesëmarrje e ultë e publikut në shqyrtimin e draft "Planit Hapësinor të Kosovës 2005 - 2015+", thotë IPH

Index Kosova realizoi anketim për mediat në Kosovë

Faqe 4

Roli i organizatave joqeveritare

Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së:
www.advocacy-center.org

Tryezë e rrumbullakët për shoqërinë civile dhe pjesëmarrjen publike

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes është esenciale për zhvillim të qëndrueshëm

Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, qeverisjes lokale dhe asaj qendrore, dhe ekspertë diskutuan për pjesëmarrjen publike në planifikimin e zhvillimit lokal, gjatë një tryeze shumëpalëshe të mbajtur më 14 qershor në Hotel Grand, Prishtinë. Takimi synonte t'i jepej shtytje shqyrtimit të një prej parimeve të qeverisjes së mirë - angazhimit qytetar në proceset e vendim-marrjes.

"Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje konsiderohet një ndër elementet kryesore të shoqërive qytetare dhe proceseve demokratike," kanë theksuar organizatorët e tryezës, iniciativë kjo e përbashkët e ATRC-së, UN Habitat-it dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Sipas organizatorëve, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është po ashtu "mënyrë e efektshme nëpërmjet së cilës qeveria dhe publiku mund të bashkëpunojnë për të adresuar çështje të karakterit zhvillimor siç janë përmirësimi i infrastrukturës lokale, strehimi, zbutja e varfërisë, përmirësimi i ambientit urban, zhvillimi ekonomik dhe përmirësimi i standardeve të sigurisë për fëmijët dhe gratë e zonave urbane".

Përderisa përfaqësuesit e qeverisë i bën thirrje shoqërisë civile të zhvilloj strategji të afritit të qytetarëve me qeverinë, përfaqësuesit e

OJQ-ve u ankuan se shoqëria civile është injoruar nga qeveria.

Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e R r j e t i t

K o s o v ë s sugjeroi themelimin e

një standardi të ri për Kosovën për pjesëmarrje të shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes.

"Shoqëria civile duhet të shërbej si urë lidhëse ndërmjet vendimmarrësve dhe qytetarëve".

Margriet Struijf, Kryesuese e Zyrës së Holandës në Prishtinë

Pas këmbimit të përvojave lidhur me angazhimin e shoqërisë civile në proceset



Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ardian Gjini, bën thirrje për procese transparente vendimmarrëse në Kosovë, më 14 qershor

e vendimmarrjes, pjesëmarrësit identifikuan kushtet të cilat duhet të plotësohen për të përmirësuar këtë proces, siç janë: reformimi i sistemit zgjedhor, shtimi i bashkëpunimit ndërmjet OJQ-ve dhe partive politike, hapja e qendrave të informimit për qytetarët në secilën komunë të Kosovës, qytetarë më aktiv, shtimi i besimit të qytetarëve ndaj institucioneve qeverisëse, pjesëmarrja më e madhe e zyrtarëve qeveritar në debatet publike dhe shtrirja e përkrahjes së donatorëve në tërë territorin e Kosovës.

Kjo tryezë është realizuar në bashkëpunim me përfaqësues të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

Aspekte të qeverisjes së mirë të identifikuar në këtë takim do të adresohen gjatë një konference për qeverisje të mirë të planifikuar për shtator 2006.



Tryeza e rrumbullakët e shoqërisë civile dhe qeverisë për pjesëmarrjen publike në proceset vendimmarrëse, 14 qershor

Ngritja e kapacitetit të shoqërisë civile në shoqëritë post-konfliktuale:

Përvoja e Bosnjës e Hercegovinës dhe Kosovës

Qendra Ndërkombëtare për Trajnim dhe Hululumtëm të OJQ-ve (INTRAC) ka publikuar në qershor një dokument për ngritjen e kapacitetit në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë. Përmbledhja ekzekutive e këtij dokumenti tregon se ai shqyrton rrugët dhe metodat e aplikuara për ngritje të kapacitetit të OJQ-ve në Bosnjë e Hercegovinë (B&H) dhe Kosovë gjatë përvojave paralele dhe të vazhdueshme të riabilitimit dhe tranzicionit post-konfliktual social, politik dhe ekonomik. Ngritja e kapacitetit është term i ri në të dy këto vende, që ka hy në fjalorin e tyre bashkë me konceptet si 'OJQ', 'shoqëri civile', 'demokraci', dhe 'qeverisje e mirë' në kuadër të një diskursi më të gjerë zhvillimi dhe përpjekjeve për të ri themeluar shtete të reja sipas demokracisë liberale të stilit perëndimor.

Në fillim, ngritja e kapacitetit të OJQ-ve ishte barazuar në trajnim për ngritje të aftësive individuale, të konsideruara të nevojshme për profesionalizëm të shoqërive civile në B&H dhe Kosovë, gjendja emergjente e të cilave është stimuluar artificialisht nga qasja e lehtë në fonde të huaja për shpërndarje të ndihmës humanitare dhe sigurim të shërbimeve esenciale, thuhet në raport.

Tekstin e plotë të këtij dokumenti mund ta gjeni në: <http://www.intrac.org/pages/PraxisPaper9.html>

Shqyrtim publik i draft ligjit për "Sigurimin Pensional dhe Invalidor"

Pensionistët kërkojnë ligj që garanton mirëqenie për pensionistët e tanishëm dhe të ardhshëm të Kosovës



Përfaqësues të pensionistëve të Kosovës gjatë shqyrtimit të draft ligjit "Sigurimi Pensional dhe Invalidor", më 10 korrik

Përfaqësues të shoqatave dhe sindikatave të pensionistëve të Kosovës; shoqërisë civile; Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Kosovës; dhe ekspertë ligjor shqyrtuan draft ligjin "Sigurimi Pensional dhe Invalidor" gjatë një diskutimi publik të organizuar nga ATRC-ja më 10 korrik në restaurant/galerinë "Hani i 2 Robertëve", Prishtinë.

Pjesëmarrësit synonin përpilimin e rekomandimeve

konkrete për këtë draft ligj me qëllim që ai të jetë gjithëpërfshirës.

Gjatë takimit, përfaqësues të Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës, Sindikatës së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, Shoqatës së Invalidëve të Punës, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Shoqatës së Minatorëve Pensionistë dhe Invalid të Kosovës paraqitën rekomandimet dhe vërejtjet e tyre për draft ligjin, i cili deri më 15 gusht do t'i dërgohet komisionit ndërmintor i angazhuar në harmonizimin e propozimeve për këtë draft ligj, para se ai t'i dorëzohet qeverisë.

Pjesëmarrësit përsëritën kërkesën e tyre për zgjidhje të menjëhershme të gjendjes së pensionistëve.

Ilaz Kurteshi, Kryetar i

Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës deklaroi se përmbajtja e këtij draft ligji është gjithëpërfshirëse dhe përfshinë të gjitha çështjet me rëndësi për pensionistët. "Mirëpo, vlera e ligjit varet nga implementimi i tij", ka thënë Kurteshi.

Naim Hoda nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale pohoi se kërkesat e Shoqatës së Pensionistëve ndikuan në fillimin e diskutimeve publike, me qëllim që draft ligji të jetë më kualitativ.

Ky dokument ligjor është hartuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Gjatë qershorit, ATRC-ja në bashkëpunim me shtatë OJQ të tjera lokale ka organizuar diskutime rajonale publike për këtë çështje në shtatë qytete: Gjilan, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Prishtinë dhe Pejë. Takimet janë përkrahur nga Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung.

Prezentim i një OJQ-je lokale

"World Child Kosova" mbron dhe përkrah fëmijët dhe të rinjtë kosovar

World Child Kosova është organizatë jo-qeveritare, jo-politike dhe jo-fetare e themeluar në janar të vitit 2002. Ekipi i World Child Kosova filloi veprimtarinë e vet para shtatë vjetësh me një program kreativ të War Child Holland, i cili synonte t'u ndihmonte fëmijëve kosovar t'i tejkalojnë traumat e luftës së fundit.

Pas themelimit si World Child Kosova, kjo OJQ ka vazhduar zgjerimin, zhvillimin dhe shtimin e programeve të veta në fusha të reja, përfshirë mësimdhënësit, të rinjtë dhe fëmijët me nevojë të ve-

çanta. World Child Kosova synon:

- Të ngritë vetëdijen e fëmijëve dhe të rinjve për ambientin ku ata jetojnë dhe t'i tejkalojnë problemet psikosociale nëpërmjet aktiviteteve Kreative dhe sportive;

- Të mbrojtë drejtat e fëmijëve dhe të rinjve, dhe t'i përkrah ata në tejkalimin e vështirësive që i hasin në shoqëri;

- T'i afrojt grupet e etniteteve të ndryshme përmes aktiviteteve të ndryshme kreative;

- T'i stimulojë dhe t'i përkrahë zhvillimet e reja kreative të sistemit arsimor të Kosovës.



World Child Kosova është OJQ, e themeluar në vitin 2002

Burimi: www.worldchildkosova.com

Për më shumë informata vizitoni këtë faqe Interneti, ose kontaktoni: worldchildkosova@yahoo.com

Pjesëmarrje e ultë e publikut në shqyrtimin e draft "Planit Hapësinor të Kosovës 2005 - 2015+", thotë IPH

Përfaqësues të Institutit për Planifikim Hapësinor (IPH) kanë shqyrtuar draft dokumentin "Plani Hapësinor i Kosovës 2005 - 2015+" me shoqërinë civile, gjatë një tryeze të rumbullakët, të organizuar më 4 korrik nga ATRC-ja.

Me anë të prezentimit vizual, Luan Nushi, Zëvendës Drejtor i IPH-së, i ka njoftuar pjesëmarrësit për strategjinë e zhvillimit hapësinor të Kosovës, duke veçuar se ajo është "bazuar në disa hulumtime". Prezentimi i tij është fokusuar në strukturën e rrjetit të vendbanimeve të këtij draft plani hapësinor.

Pjesëmarrësit shprehën shqetësimin e tyre për resurset natyrore, duke pohuar se ato duhet të mbrohen institucionalisht dhe të shfrytëzohet racionalisht.

IPH është ankuar për nivelin e ulët të pjesëmarrjes publike në shqyrtimet e draft planit hapësinor, të quajtur "Kosova shtëpia jonë".

Ky ishte diskutimi i dytë publik i këtij lloji i organizuar nga ATRC-ja. Diskutimi i mëparshëm është mbajtur më 23 maj, kryesuar nga Ilir Gjinolli, Drejtor i IPH-së.

Publiku mund të sugjeroj ndryshime gjatë dy muajve të ardhshëm para se dokumenti t'i dorëzohet qeverisë.



Qytetarët mund t'i dërgojnë komentet ose sugjerimet e tyre në: komentet.planihapësinor@yahoo.com ose komentet.planihapësinor@ks.gov.net

Përfaqësues të shoqërisë civile bëjnë thirrje për reformim të sistemit zgjedhor në Kosovë

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), në bashkëpunim me Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) kanë organizuar më 5 qershor tryezë të rumbullakët të titulluar "Legjislacioni për zgjedhje në Kosovë: Kush? Çfarë? Ku? Si?"

Takimi, në të cilin morën pjesë përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, partive politike dhe shoqërisë civile, rezultoi me disa konkluzione:

- Trendet brengosëse siç janë rënia e daljes në votim dhe rënia e besimit ndaj qeverisë mund të vëzhgohen.
- Pjesëmarrja e qytetarëve ka nevojë të shtohet dhe se reformat e sugjeruara nevojitet të lidhen me refor-



mat institucionale dhe organizative me qëllim të arritjes së rezultateve.

- Sistemi zgjedhor ka nevojë të ndryshoj: ekziston konsensus lidhur me shfrytëzimin e listave të hapura dhe përfaqësimit proporcional.

- Një ligj i vetëm për zgjedhje ose një "Kod Zgjedhor", i cili do të rregullonte zgjedhjet kombëtare, lokale dhe për kryetarë komunash është i nevojshëm.

- Procesi i reformave dhe i përcaktimit të legjislacionit të ri zgjedhor duhet të jetë gjithëpërfshirës, përfshirë shoqërinë civile dhe të gjitha bashkësitë etnike.

- Pasi që shumë palë po merren me çështjen e zgjedhjeve, UNMIK-u/OSBE-ja, qeveria dhe ministritë përkatëse, Kuvendi i Kosovës dhe komisionet relevante, shoqëria civile, donatorët dhe akterët e tjerë nevojitet t'i koordinojnë aktivitetet e tyre.

- Është e domosdoshme që kosovarët të kenë pronësi më të madhe në këtë proces dhe kalim gradual, por të përshpejtuar, të kompetencave.

Për më shumë informata, kontaktoni info@kipred.net

Publikim i OJQ-ve

Index Kosova realizoi anketim për mediat në Kosovë

Index Kosova ka publikuar në qershor rezultatet e një anketimi për gazetat ditore, radio dhe TV stacionet e Kosovës. Puna në terren, e realizuar në periudhën 23 deri më 29 maj, ka përfshirë 1,104 respondentë të moshës 15+ vjet, përfshirë


shqiptarë dhe minoritete jo serbe.

Figurat e mëposhtme paraqesin nivelin e shikueshmërisë së TV kanaleve kombëtare dhe të lexueshmërisë së gazetave ditore, bazuar në rezultatet e anketimit.

Publikimin e plotë, përfshirë


burimin kryesor të të dhënave, radio stacionet më të besueshme dhe më të dëgjueshme, TV stacionet më të besueshme dhe më të shikueshme dhe gazetat më të besueshme, mund ta gjeni në: www.indexkosova.com (Media in Kosovo).

Shikueshmëria e TV Kanaleve Kombëtare



RTK-ja vazhdon të jetë TV stacioni më i shikueshëm, me 43% të shikueshmërisë

Lexueshmëria e Gazetave Ditore



Koha Ditore vazhdon të jetë gazeta më e lexueshme, me afro 40% të lexueshmërisë



Drejtoreshë Ekzekutive
RREZE DULI
rreze@advocacy-center.org

Menaxher i Financave & Administratës
GANI ASLLANI
gani@advocacy-center.org

Trajnere & Konsultante
MERITA BARILEVA
merita@advocacy-center.org

Trajnere & Konsultante
DONIKA SALIHU
donika@advocacy-center.org

Menaxhere për Komunikim & Ndërlidhje
ARJETA DOROCI
arjeta@advocacy-center.org

Bashkëpunëtore e Programit
NATYRA ZHJEQI
natyra@advocacy-center.org

Menaxher për IT dhe Databasë
ARSIM KOSUMI
armend@advocacy-center.org

Rr. Agim Ramadani Nr. 15
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244
810

Parimet e Demokracisë

Roli i organizatave joqeveritare

Në shoqëritë demokratike, qytetarët e rëndomtë mund të organizojnë grupe të pavarura, të cilat u shërbejnë nevojave të komunitetit ose vendit në të cilin jetojnë dhe ndihmojnë, plotësojnë ose sfidojnë punën e qeverisë. Organizatat e tilla quhen organizata joqeveritare, ose OJQ, sepse nuk veprojnë në kuadër të zyrave qeveritare

OJQ-të u mundësojnë qytetarëve të përmirësojnë shoqërinë e tyre duke avokuar, edukuar, tërhequr vëmendjen ndaj çështjeve me rëndësi publike dhe monitoruar punën e qeverisë dhe ndërmarrjeve private.

OJQ-të u mundësojnë qytetarëve në mënyra të ndryshme që të mësojnë të punojnë së bashku dhe t'i përmirësojnë aftësitë, marrëdhëniet, dhe të ngritin besueshmërinë e nevojshme për qeverisje të mirë.

OJQ-të iu shërbejnë në masë të madhe interesave të qytetarëve. Ato mund të veprojnë si sigures të shërbimeve sociale, të avokojnë për ambient ose për standardet e jetesës, punës, ose të shërbejnë si katalizator për ndryshime demokratike.

OJQ-të shpesh përfaqësojnë interesat e atyre qytetarëve të cilët mund të anashkalohej nga debatet për politikat kombëtare. Ato inicojnë fillimin e diskurseve publike për njerëzit e të gjitha klasave ekonomike dhe shoqërore, për gra dhe minoritete.

Financimi i OJQ-ve mund të rrjedh nga donacione private individuale, filantropitë private, korporatat, institucionet fetare, institucionet ndërkombëtare, OJQ e tjera, shitja e mallrave dhe shërbimeve, madje edhe



nga qeveritë.

Qeveritë dhe OJQ-të shpesh punojnë si partnerë. OJQ-të mund të ofrojnë ekspertizë lokale dhe rajonale, si dhe personel për hir të implementimit të projekteve të financuara nga qeveria. OJQ-të mund të jenë politikisht të paangazhuara, ose mund të bazohen në ideale të caktuara dhe kërkojnë të avancojnë një çështje të caktuar ose një sërë çështjesh me interes publik.

OJQ-të zhvillojnë programe lokale dhe ndërkombëtare në pothuajse të gjitha fushat që kontribuojnë në promovimin e parimeve të demokracisë, përfshirë:

- të drejtat e njeriut (duke promovuar standarde ndërkombëtare dhe monitoruar shkeljet dhe abuzimet),

- sundimi i ligjit (përmes ndihmës juridike të lirë ose

falas, edukimit të të gjithë qytetarëve për të drejtat e tyre, dhe avokimit për reforma juridike),


- pjesëmarrja e grave (duke i përgatitur ato për pjesëmarrje politike dhe duke i mbrojtur nga diskriminimi socio ekonomik),

- edukimi qytetar (përmes programeve edukative të fokusuara në rolin e qytetarit në një shoqëri demokratike dhe të shumëllojshme)

- shtypi i lirë (duke promovuar media të pavarura, trajnuar gazetarët, dhe vendosur standarde për gazetari etike),

- zhvillimi i partive politike (përmes monitorimit të zgjedhjeve nga vëzhgues të trajnuar vendor dhe numërues jopartiak të votave), dhe

- llogaridhënia qeverisëse (duke realizuar analiza politike dhe shërbyer si vëzhgues të veprimeve qeverisëse).



Burimi: Usinfo.state.gov

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.